



**Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

07 Nr. 320-22002/19

Klinë, me 05.06.2019

**Projekt komunal për përkrahjen në zhvillimin e bletarisë (koshereve)**

Në kuadër të Zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë, bletarisë Komuna Klinës respektivisht Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural publikon:

**SHPALLJE**

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e Bletarisë-Koshereve të Bletëve.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në këtë projekt do të kontribuojë me:

- Financimin e Koshereve
- Këshillime profesionale dhe monitorim të vazhdueshëm të fermerëve përmes eksperteve të kësaj drejtorie.

**Kriteret e konkurrimit:**

1. Fermeri duhet të jetë qytetar i komunës së Klinës
2. Të ketë njohuri evidente në kultivimin e Bletëve
3. Të posedojë minimumin 5 koshere Bletë
4. Përparasi kanë fermerët e zonave rurale si dhe ata të cilët nuk kanë përfituar projekte nga komuna
5. Partecipimi i fermerit është 30%

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:**

1. Kërkesa e shkruar nga vete fermeri, numri i koshereve që posedon fermeri në pronësi dhe numri kontaktues i telefonit
2. Vertetimi i tatimit në prone
3. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës

**Afati i Aplikimit nga data 05.06.2019 deri me 17.06.2019**

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyrën e arhivës komunale dhe regjistrohen në protokollin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Klinë

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen

Drejtori i DBPZHR  
z. Naser Morina

